



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 126 Datë 28.10.2021

**PËR MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË NJËSISË SË MENAXHIMIT TË  
BANESAVE ME QËLLIM SOCIAL**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, duke u bazuar në ligjinnr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjinnr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Ligjin 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin Plotësues nr. 4 datë 25.1.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, si dhe Udhëzimin nr. 24 datë 29.8.2019 i MFE “Për përdorimin e arkivës elektronike në procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar dhe mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

**VENDOSI**

1. Të miratojë mbylljen e Institucionit të Njesisë së Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social me kod 2122021 dhe nipt L34631191T.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Erjon Nexhipi**

